NFFIS/SKIZP është një sistem i integruar web-GIS për parandalimin e zjarrit d paralajmërimin e hershëm dhe ndan informacionin me agjencitë përkatëse.

Sistemi Kombëtan i Informacio. Zjannet në Pyje

Photo by

MANUAL I PËRDORIMIT



Manual për përdoruesit e Sistemit Kombëtar të Informacionit për Zjarret në Pyje

Për çasje publike

Në këtë manual janë përshkruar hapat që duhen ndjekur për kryerjen e punëve në sistemin SKIZP

nga Geo&Land llc

1.	Hy	rje	4
1.	1	Hyrje në GIS	4
2.	Τë	dhënat gjeohapësinore	5
2.	1	Të dhënat vektoriale	5
2.	2	Të dhënat rasterike	6
3.	Fill	imi	7
3.	1	Përmbledhje e përgjithshme	7
4.	Pëi	rdorimi i përgjithshëm i NFFIS-it	8
4.	1	Metadata	. 27
4.	2	Grafiku	. 30
4.	3	Printimi	. 32
4.	4	Kërkimi	. 34
4.	5	Të dhënat historike	. 35
4.	6	Veglat - Redaktimi	. 39
4.	7	Libërshënuesi hapësinor	. 43
Ind	ex		45

1 Hyrje

1.1 Hyrje në GIS

Sistemi i Informacionit Gjeografik (SIG) është një koleksion programesh që ju lejon të krijoni, vizualizoni, kërkoni dhe analizoni të dhënat gjeohapësinore. Ai kombinon të dhënat gjeografike dhe teknologjinë për të ofruar njohuri të vlefshme në fenomene të ndryshme të botës reale dhe marrëdhëniet e tyre.

Të dhënat gjeohapësinore i referohen informacionit për vendndodhje gjeografike të një entiteti. Kjo shpesh përfshin përdorimin e një koordinate gjeografike, si një vlerë e gjerësisë ose gjatësisë. Të dhënat hapësinore janë një tjetër term i përdorur zakonisht, siq janë: të dhënat gjeografike, të dhënat GIS, të dhënat e hartës, të dhënat e vendndodhjes, të dhënat e koordinatave dhe të dhënat e gjeometrisë hapësinore.

GIS funksionon në parimin se vendndodhja është një aspekt themelor i shumicës së të dhënave. Duke organizuar dhe analizuar të dhënat në hapësirë, GIS na ndihmon t'u përgjigjemi pyetjeve, të marrim vendime të informuara dhe të zgjidhim problemet që kanë një komponent hapësinor. Na lejon të eksplorojmë modele, marrëdhënie që mund të mos jenë të dukshme në të dhënat tradicionale tabelare.

Aplikimet e GIS janë të gjera dhe të larmishme. Ai përdoret në fusha të tilla si planifikimi urban, menaxhimi mjedisor, transporti, menaxhimi i burimeve natyrore, shëndeti publik, reagimi ndaj emergjencave dhe analiza e biznesit, ndër të tjera. Disa raste të përdorimit të zakonshëm përfshijnë hartimin dhe vizualizimin, analizën hapësinore, modelimin dhe simulimin dhe sistemin e mbështetjes së vendimeve.

Fusha e GIS vazhdon të evoluojë me avancimet në teknologji dhe disponueshmërinë e të dhënave. Platformat GIS të bazuara në Web dhe aplikacionet celulare i kanë bërë të dhënat gjeohapësinore më të aksesueshme dhe kanë mundësuar përditësimet e të dhënave në kohë reale.

GIS është një mjet i fuqishëm për të kuptuar dhe analizuar të dhënat gjeografike. Na ndihmon të zhbllokojmë dimensionin hapësinor të informacionit dhe të fitojmë njohuri të vlefshme për vendimmarrje të informuar në një gamë të gjerë disiplinash.

2 Të dhënat gjeohapësinore

Të dhënat gjeohapesinore i referohen çdo lloji të të dhënave që lidhen me një vendndodhje specifike në sipërfaqen e Tokës. Përfshin informacion hapësinor dhe tabelar, duke kombinuar koordinatat gjeografike (gjerësia, gjatësia dhe ndonjëherë lartësia) me atribute përshkruese që ofrojnë detaje shtesë rreth vendndodhjes ose veçorisë.

Janë dy lloje të të dhënave gjeohapësinore: të dhëna Vektoriale dhe Rasterike.

2.1 Të dhënat vektoriale

Një ndër të dhënat gjeohapësinore janë të dhënat vektoriale. Në kuptimin me të thjeshtë, vektorët janë një mënyrë për të përshkruar një vendndodhje duke përdorur një grup koordinatash. Ky lloj i të dhënave përfaqëson veçoritë gjeografike si pika, vija ose poligone.

- Pika një koordinatë e vetme (x,y) përfaqëson një vendndodhje gjeografike, p.sh. një pikë referimi, një adresë, etj.
- Vijë grup koordinatatsh (x1,y1; x2,y2;xn,yn) të lidhura së bashku në një renditje të caktuar, si vizatimi i një vije nga pika 1 deri në pikën 2 e kështu me radhë. Me linja (vija) mund të paraqiten veçori si: rruga, lumi etj.
- Poligoni është kur linjat janë të lidhura së bashku me më shumë se dy pika, ku pika e fundit është në të njejtin vend si e para. Një formë trekëndeshi, katrori, katërkëndëshi, ejt. janë poligone. Me poligone mund të paraqiten sipërfaqe si: kufijtë e një vendi, parcelat e tokës, një sipërfaqe e caktuar, etj.



Të dhënat vektoriale ruajnë si gjeometrinë (koordinatat) ashtu edhe atributet (p.sh. emrat, popullsinë, përdorimin e tokës, etj.) të veçorive.

2.2 Të dhënat rasterike

Të dhënat rasterike gjithashtu janë një lloj i të dhënave gjeohapësinore që mund të përdoren në një sistem Web GIS.

Të dhënat rasterike përfaqësohen si një rrjet qelulash ose pikselësh, ku çdo qelulë përmban një vlerë që përfaqëson një atribut specifik. Forma më e madhe e të dhënave rasterike janë imazhet digjitale satelitore ose fotografitë ajrore. Modelet digjitale të lartësisë gjithashtu janë të dhëna rasterike.

Një raster është një rrjet i rregullt i përbëre nga qelulat, ose në rastin e imazheve, pikselat. Ata kanë një numër rreshtash dhe kolonash. Çdo qelulë ka një vlerë numerike dhe ka një madhësi të caktuar gjeografike (p.sh. madhësia 20x20 cm).



3 Fillimi

Ky kapitull paraqet një pasqyrë të aplikacionit WebGIS për sistemin "Zhvillimin e sistemit Nacional të Informacionit të Zjarreve Pyjore (NFFIS)", procedurës së hyrjes dhe komponentëve kryesore të sistemit.

3.1 Përmbledhje e përgjithshme

Funksionaliteti kryesor i sistemit NFFIS është shfaqja dhe ndërveprimi me të dhënat hapësinore, si hartat (të dhënat) vektoriale dhe hartat (të dhënat) rasterike. Sistemi funksionon së bashku me Geoserverin (<u>http://geoserver.org</u>) dhe PostgreSQL (<u>http://www.postgresql.org</u>/) për të kompletuar një sistem gjithëpërfshirës për shfaqjen e hartave.



Pasi përdoruesi të vendos kredencialet e tij të sakta, mund të drejtohet direkt tek pjesa Hartat.



Kur klikoni mbi *Hartë*, hapet faqja e Hartave dhe ju mund të shihni grupe të hartave në këtë faqe.



Klikojmë tek grupi NFFIS dhe shfaqen hartat e integruara në këtë grup, si: Harta e Analizës së shpejtë, APK, AKK përgjithëshme, SKIZP, Të dhënat historike, QOER, etj.

Hartat përkatëse i kanë poashtu edhe përshkrimet e tyre rreth përdorimit si dhe kush ka qasje në të. Jo çdo përdoruesi mund t'i sheh të gjitha harta brenda grupi por këtë e definon Administratori. Në sistem, përveq grupit të hartave që i takojne NFFIS kemi kriju edhe nje grup të hartave për projektin dhe të dhënat hapësinore të Restelicës, Harta e rrezikut nga orteqet.

Þ	NFFIS * * * * ** ** ** ** ** ** ** ** ** **
હ	Nex mecha ochlaherti led poje de gentral gedille, die conversitional de led poje de gentral gedille, die conversitional de led poje de gentral de led poje de gentral gedille, die conversitional de led poje de gentral de gentral de led poje de gentral de led poje de gentral de led poje de gentral de gentral de led poje de gentral de gent
ഠ	alting has been by a constraint of the second of the secon
۲	Kit Pergjithëshme AKK Pergjithëshme Arac 400 datë në kë përd di pethese kënjë dhe së detë e në së dë së entitisë "OrëRABA" (Che se qare
₿	And the factors of t
đ	Te dhénat historike Te dhénat historike Ve Waster te kasji karte <u>Ta kidnat Historike</u> Ve Waster te kasji karte <u>Ta kidnat Historike</u>

Pas klikimit të butonit Shfaq hartën **ku shfaqet harta në regjionin e caktuar si në figur**ë.

në hartën e zgjedhur, hapet një dritare e re

NFFIS-Q0E
 Qendra Operative Emergiente 112



Faqja kryesore e WebGIS NFFIS përbehet prej panelit kryesore të hartës, prej banerit lartë, panelit majtas, shiritit të veglave djathtas, kërkimit në hartë, të cilat në vazhdimësi do të shpjegohen të gjitha.

Paneli i hartës ofron paraqitjen kryesore të sipërfaqeve, pra paraqitjen grafike të shtresave të cilat janë të integruara në sistem.



Përmbajtje e hartës është baneri lartë

WFFIS-QOE Qendra Operative Emergjente 112	🗮 Change Map	💄 raportuesi	۵,	€ About	English 🔹	🛠 Home

i cili ka në përbërje: në anën e majtë është paraqitur logoja e Agjencisë së Menaxhimit të Emergjencave dhe emri i departamentit, punonjesit e te cilit do të punojne me këtë sistem (hartë).

Pastaj në anën e djathtë është butoni për ndrrim të hartës *Ndrysho hartën*, ku pas klikimit në këtë buton hapet një dritare ku është dhënë mundësia për ndërrim të hartës. Hartat e integruara kanë përmbajtje ndryshe nga njëra tjetra.



Tek butoni për ndërrim të hartës është paraqitur emri i përdoruesit që është i kyqur në këtë sistem, ku pas klikimit mbi të hapet dritarja ku mund të bëni çkyqjen nga sistemi.



Në radhë është vegla e njoftimeve, nëse klikohet mbi të shfaqen nëse keni apo jo ndonjë njoftim, dhe tek shkrimi në fund Shiko në hartë mund të klikoni nëse keni njoftime dhe mund ti shihni ato si një list të tërë.



Vegla *About* tregon rreth aplikacionit, se nga kush është zhvilluar alikacioni, nga kush menaxhohet dhe kontakti për kompaninë.



		🖶 Ndrysho hartên	🚢 qoerpr 🗘
esal	Harta e NFFIS-it		
a 255	NFFIS	11.2	
Leposaviq	jîca) 🚳		
13	Sistemi Informatik Nacional i Zjarreve ne Pyje		
s l	Implementuar nga		
	Perkrahje nga		
Min	Perfitues	ain a	
	💡 Prishtine - Kosova 🚦 +383 38 7392 193 🐸 info@geoland-kosova.com		
	Podujeve		

Sistemi nacional për zjarret pyjore është i ndërtuar në tre gjuhë, shqipe, angleze dhe serbe, ku me një vegël të integruar në sistem mund të ndërrohet gjuha.

	€About	Shqip 🔺	😭 Нс			
		English				
		🕷 Shqip				
		Serbisht				
	_					
Vegla e fundit tek baneri lart ë sistemit.	shtë vegla	Home Home	ku r	a kthen në	faqen k	ryesore të

Sisteme koordinative të WebGIS NFFIS

Gen @ OpenStreetMap contributors. Nation Forest Fire information System

Në pjesën e poshtme anën e majtë të hartës shkruan cila hartë bazë është në përdorim. Në anën e djathtë është paraqitur shkalla e zvogëlimit, sistemi koordinativ (KosovaRef01 apo WGS84) si dhe sistemi koordinativ ushtarak MGRS.

Sistemi koordinativ mund të ndryshohet nga ai KosovaRef01 në WGS84 dhe anasjelltas, duke klikuar mbi shenjën e miun.

1:1000 • 🛢 X: 7516628,96316, Y: 4722407,73951 [EPSC:9141] MGRE 10m:34TEN16622099 🔗



Koordinatat ushtarake MGRS janë grid hartash çdo 100km, 10km, 1km, 100m.





Shtresat dhe Veglat

Pjesë tjetër e hartës është edhe paneli majtas i Veglave dhe Shtresve.



Paneli majtas ka në përbërje shtresat ku tregon se cilat shtresa janë të integruara në hartë, pastaj shtresat bazë që kryesisht përdoren si prapavijë në hartë (p.sh ortofotot, hartat topografike, hartat e openstreetmap, etj.) dhe që nuk mund të aktivizohen dy shtresa bazë njëheritë.

Tek *Shtresat* janë të radhitura shtresat (layer-at) me emër të hartës në këtë rast : Qendra Operative Emergjente 112, si grup ku në vete i përmban shtresat qe janë të nevojshme për këtë departament, p.sh:

- Kufijt Administrativ
- Rrugët, etj.

të cilat me anë të klikut në kutinë majtas (siq shihet në figurën më lartë) mund ti aktivizosh ose jo. Shtresat aktive lexohen me shkronja të bardha, kurse ato joaktive janë të hijezuara. Të hijezuara poashtu mund të shihen shtresat me shkallë të kufizuar të paraqitjes, pra këto shtresa i kanë të paracaktuar paraqitjen e tyre, varësisht nga shkalla e zvogelimit të hartës (shkallën minimale dhe ato maksimale).



Nëse klikohet me tastin e djathtë të miut mbi shtresën përkatëse, shfaqen opcionet/mundësitë të ndryshme për shtresën.

- Metadata të dhënat e përgjithshme të shtresës,
- Transparenca paraqitja transparente e shtresës, e shkrehur në përqindje,
- Zmadho në shtresë afrohet tek shtresa,
- Hap tabelën e të dhënave tabela e të dhënave të shtresës,
- WMS URL kopjon linkun e ueb shërbimit të hartës,
- WFS URL kopjon linkun e ueb shërbimit të veçorisë.

Inicimi i Ngjarjes-In Point	cidentit
1 Metadata	
≢ Transparence	>
Q Z madhoni në sht	resë
🔲 Hap tabelën e të	dhënave
🖽 WMS URL	0
🖽 WFS URL	0

Në raste, kur shtresa i ka disa përmbajtje, stilizimi i shtresës mund të ndryshohet varësisht nga përmbajtja e saj; p.sh. shtresa Popullsia në Komuna mund të shihet në stile të ndryshme varësisht nga të dhënat sipas numrit të popullsisë apo sipas dendësisë së popullsisë.

🍘 Stilet	>	Dendesise
Q Zmadhoni në shtresë		Popullesise (parazgjedhje)

Tek *Tabela e të Dhënave* janë të paraqitura të dhëna të ndryshme të shtresës përkatëse. Tabela mund të zmadhohet/zvogëlohet sipas nevojës.

Tek *Kërko* mund të bëhet kërkimi i përgjithshëm për të gjithë të dhënat e tabelës. Poashtu, këto të dhëna mund të klasifikohen sipas atributeve të shtresës përkatëse tek secila kolonë.

apkr_	ngastra												141	×
Show 1	.0 🗸 🕅											Search		
	id	Nr Rajoni	Rajoni	Nr NJM	Njesia Menaxhuese	Ngastra	subngastra	Numri i nenngastrave	Siperfaqja ha	Perimetri m	γ	Х	Gjatesia	G
	id 🔺	Nr Rajoni 🔶	Rajoni 🕴	Nr NJM 🔅	Njesia Menaxhuese 🖗	Ngastra 🕴	subngastra 🖗	Numri i nenngastrave	Siperfaqja ha	Perimetri m 🖗	γ	x	Gjatesia 👌	Gj
	5200	01	PRISHTINË	01	Prishtinë I	100	0	14	19.2161	6555	7527118.26	4718318.83	21.33049	^
	5201	01	PRISHTINË	01	Prishtinë I	099	0	3	38.0796	5525.9	7528675.84	4716947.53	21.3494	
	5202	01	PRISHTINË	01	Prishtinë I	098	0	2	36.6651	3383	7528828.34	4717919	21.35131	
	5203	01	PRISHTINË	01	Prishtinë I	097	0	1	59.3412	3567.5	7529117.31	4718724.76	21.35487	
4	5001	~*	DDIOUTUUP	••			•	2	F + 0000	5007 A	3500005.01		•	*
Showing	g 1 to 10 of 6	,228 entries							Previous	1 2 3	3 4	5	623 Nex	ct

Lista e tabelës mund të jetë e gjatë varësisht nga numri i reshtave që përcaktohet. Poashtu është edhe butona për shfaqen e veçorive të dukshme, ku si rezultat në tabelën e të dhënave do të paraqiten vetëm të dhënat e veçorive që janë të dukshme në hartë.

apkr	_gjit	the_r	Shfaq vecoritë
Shfaq	10 🗸		е
1	10		dukshme
	25	Kosov	ne narte
\square	50	Kacau	Dof A v

Tek shtreat poashtu është integruar edhe komponenta *TEMA*, që mundëson aktivizimin e temave të caktuara.



Varësishtë prej departamentit dhe rolit që ka përdoruesi, mund të klikon në temën përkatëse dhe aktivizohen shtresat që i takojnë asaj teme, p.sh. për temën AMMK në hartë do të shfaqen shtresat që i përkasin kësaj teme (Zonat e mbrojtura, Zonat e rrezikshme, etj).



Kurse për temen Emergjenca në hartë do të shfaqen shtresat përkatëse të kësaj teme (Stacione policore, Zjarrfikesit, etj).



Tek *hartat bazë* (basemap): janë të integruar hartat bazë të cilat mund të përdoren në cilëndo hartë. Këto harta janë të parapregatitura dhe janë të burimeve të ndryshme si: AKK, OSM, etj. në këtë komponent janë të integruara këto harta bazë:

- OSM (open street map standart)
- Orto2012 (ortofotot e vitit 2012 nga AKK)

- Topo8 (Hartat topografike të vjetra)
- Topo15 (Hartat topografike të reja)
- OpenTopoMap
- Humanitarian OSM (open street map me komponente humanitariane)
- Asnjë hartë bazë (nëse dëshironi që mos të keni të aktivizuar ndonjë hartë bazë).



Tek pjesa *Legjenda* është paraqitur legjenda për shtresat e integruara, ku kjo ndihmon për të kuptuar dhe lexuar elementet që janë të paraqitura në hartë. P.sh. shtresa (layeri) "Ngjarjet e përfunduara" tek legjenda tregon se me çfarë simboli dhe çfarë stili është e kategorizuar kjo shtresë dhe është paraqitur në hartë (shih figurën e mëposhtme).



Pjesa lartë e panelit ka në përbërje veglat si: Metadata, Grafik, Printimi, Kërkimi, Të dhënat historike, Veglat, WMS, Libërshënuesi hapësinor (si në figurën e mëposhtme).



Shiriti i veglave:

Fit to extent	Me këtë vegël mund të zmadhoni gjithe hapesirën në shtrirje.
Zoom in	Mund të rrisni nivelin e zmadhimit
Zoom out	Mund të zvogëloni nivelin e zmadhimit

Zoom to box	Zmadhon hartën në një masë të përcaktuar nga përdoruesi Vizatoni dhe përcaktoni zonën për të zmadhuar
Query layer	Një shtresë pyetëse është një shtresë që lejon përdoruesit të marrin ose filtrojnë të dhëna bazuar në kritere specifike. mund të përdoret për të nxjerrë ose analizuar nëngrupe të dhënash brenda një grupi më të madh të të dhënave.
Query BBox layer	Shtresa e kutisë së pyetjeve është një shtresë që lejon përdoruesit të zgjedhjin veçori ose të dhëna brenda një zone ose kufiri të caktuar.
Query by polygon	Kërtimi sipas poligonit është një mënyrë për të zgjedhur ose filtruar të dhënat brenda një zone ose kufiri të caktuar të përcaktuar nga një formë poligoni
Add Layer	Me këtë vegël ju mund të shtoni nje shtresë, me një format që është i pranushëm për sistemin. Formatet e shtresave janë këto: .geojson, .kml, .kmz, .gpx, .csv, .gml, .zip(s hapefile), .json.
Length	Vegla për matjen e gjatësisë ju lejon që të matni gjatësinë e distancës që vizatoni në hartë
Area	Vegla për llogaritjen e sipërfaqes, llogarit sipërfaqen e poligonit që vizatoni në hartë
Screenshot	Me kete vegel ju mund te beni screen harten
Geoscreenshot	Me veglen geoscreenshot ju mund te shkarkoni nje fotografi e cila eshte e gjeoreferencuar dhe mund te perdorni nje nje program te caktuar.

Query layer: në një aplikacion Web GIS, vegla query layer lejon përdoruesit të marrin apo filtrojnë të dhëna bazuar në kritere apo kushte specifike. Shtresa e pyetjeve mund të përdoret për të nxjerrë ose analizuar nëngrupe të dhënash brenda një grupi të dhënash më të madh, bazuar në atribute te caktuara, vendndodhje ose kritere të tjera.

Klikimi mbi hartë me veglën query layer jep rezultatet, për ato shtresa që janë klikuar, në rastin si në foton më poshtë: një ngjarje-incident, një rajon, një komune.

gjarjet-In	cident (e r	eja) (1)	Đ	-
	Nr. ngja	Qendra orjes Operative	Lloji	
	0039/20	023 04 PRIZ	Zjarre P	
Informaci mbi ngjarj	one Lokació	oni Pershkrir	ni Tjera	Í
Bashkeng	jitjet			
Nr. ngjarjes	0039/2023	Qendra Operative	4 PRIZREN	
Lloji	Zjarre Pyjore	Ngjarja kryesore))	
Data	2023-03-03	Koha/ora 1	5:04:42.000	
Statusi		E RE		
				5
ijone (1)			Đ	J,,
ijone (1)	Emri	name_sr	name_en	
ajone (1) 🛯 🗢 🔗	Emri PRIZREN	name_sr PRIZRENI	name_en PRIZRENI	
ajone (1) Emri	Emri PRIZREN PRIZREN	name_sr PRIZRENI	name_en PRIZRENI	
ajone (1) B O <i>O</i> Emri name_sr	Emri PRIZREN PRIZREN PRIZRENI	name_sr PRIZRENI	name_en PRIZRENI	
ajone (1) Emri name_sr name_en	Emri PRIZREN PRIZREN PRIZRENI PRIZRENI	name_sr PRIZRENI	name_en PRIZRENI	
ajone (1) Emri name_sr name_en code	Emri PRIZREN PRIZRENI PRIZRENI PRIZRENI 04	name_sr PRIZRENI	name_en PRIZRENI	
ajone (1) Emri name_sr name_en code	Emri PRIZREN PRIZRENI PRIZRENI 04	name_sr PRIZRENI	PRIZRENI	
ajone (1) Emri name_sr name_en code	Emri PRIZREN PRIZRENI PRIZRENI 04	name_sr	PRIZRENI	

Tek rezultatet, për çdo veçori mund të punoni me veglat që janë të listuara brenda rezultateve

zoom to feature	Zmadhoni vendndodhjen e veçorisë
emove feature from results	Mund të largoni një ose më shumë veçori nga rezultatet
Add/Remove selection	Kjo vegël mundëson të shtoni apo të largoni nje veçori nga përzgjedhja
Copy map URL	Kopjo URL-në e hartës me shtrirjen e veçorive të gjeometrisë
Editing	Duke klikuar këtë mjet, mund të editoni gjeometrinë e veçorisë së zgjedhur

Shto shtresë: vegla *Shto Shtresë* mundëson që në sistem mund të ngarkoni një shtresë me të dhënat që dëshironi. Pas klikimit të vegles *Shto shtresë* hapet dritarja si në foton më poshtë. Pas klikimit tek shigjeta poshtë zgjedhet shtresa që do të shtohet në hartë (mund edhe të tërhiqet e të leshohet mbi dritare), përcaktohet projeksioni dhe ngjyrën e shtresës, pozitën se ku të vendoset shtresa lart apo poshtë në listën e shtresave (në anën e majtë të hartës), dhe atributet e shtresës të cilat deshironi që të shfaqen në hartë.



Sistemi i përkrah skedarë të formatit .gml, .gmx, .csv, zip(shapefile), .kmz, kurse preferohen .kml dhe .geojson.

Projeksioni i shtresës rekomandohet që të jetë njëra nga keto:

- EPSG:9141 KosovREF01
- EPSG:4326 WGS 84 koordinata gjeografike (gjatësi dhe gjerësi gjeografike).



Tek foto lartë mund të shihet shtresa *Matje terreni kosovaref01* (.*geojson*) është shtuar në hartë, ku mund të bëhet zmadhim në këtë shtresë, ndryshim i ngjyrës së shtresës si dhe mund të shkarkohet.

Në këtë formë veprohet edhe me shtresa të projeksionit WGS84.



Kjo shtresë e shtuar është shtresë e përkoheshme dhe nuk ruhet në sistem!

4.1 Metadata

Metadata: janë të dhëna që japin informacione për të dhënat tjera, pra metadata do te thote "të dhenat rreth të dhënave". <u>Metadata</u> 27 përkufizohen si të dhëna që ofrojnë informacion për një ose më shumë aspekte të të dhënave. Përdoret për të përmbledhur informacionin bazë rreth të dhënave që mund ta bëjnë më të lehtë gjurmimin dhe punën me të dhënat specifike. Disa shembuj përfshijnë:

- mjetet për krijimin e të dhënave,
- qëllimi i të dhënave,
- koha dhe data e krijimit të të dhënave,
- autori i të dhënave,
- lokacioni se ku janë ruajtur të dhënat,
- standartet e përdorura,
- madhësia e skedarëve,
- kualiteti i të dhënave burimi i të dhënave,
- procesi i përdorur për krijimin e të dhënave.

Pas klikimit tek *Metadata* hapet një dritare ku përmban tri kategori: *I përgjithshëm*, *Hapësinore* dhe *Shtresat*.

Metadata

TITULLI EMRI FJALËT KYÇE TARIFAT KUFIZIMI I QASJES KONTAKTET

0 1

Telefoni

			>
PËRGJITHSHËM	HAPËSINORE	# SHTRESAT	
Q0E 112			
WMS			
Stacione, policore, sh	endetsore, qml, ami, zjarriikes		
no conditions apply			
Nane			
🛓 Referencat	Personi mgika Organizata AME Pozita		

Tek I PËRGJITHSHË janë dhënë informacione të përgjithshme për Hartën si: titulli, emri, përshkrimi, fjalët kyqe, kufizim i qasjes në sistem, kontakte.

Pastaj është pjesa HAPËSINORE që paraqet të dhënat gjeografike për hartën si: shënime për sistemin koordinativ që është përdorur, dhe gjithashtu shtrirjen hapësinore në koordinata.

	0 I PËRGJITHSHËM	HAPËSINORE	SHTRESAT
EPSG	EPSG:9111 prog=tmerc +lat_0=0 +lon_0=21 +l false false [7414471.035537965,4631025.545	=0.9999 +X_C= 7500000 +Y_D=0 +allps=GK530 +towgs84=0,0,0,0,0,0,0 +un 1922905, 7504961.316559083, 4790325.379197936	rs=m +no_ćefs
BBOX	MINX 7416000 MINY 4572000 MAXX 7568000		

Pjesa e tretë tek <u>metadatat</u> eshtë *SHTRESAT*, ku në të janë informacionet për të gjitha shtresat (janë të paraqitura si listë).

■ Met	adata		×
		HAPËSINORE	≡ SHTRESAT
闼	Inicimi i Ngjarjes-Incidentit		+
W	E re (per verifikim)		+
Ø	E Verifikuar		+
ወ	E Rrejshem		+
	E Mbyllur		+
Ø	Gjithe Ngjarjet-Incidente		+
ወ	Raporti i demeve nga zjarri		+
Ø	Demeve nga zjarri - Plotesim		+
Ø	Demeve nga zjarri - Derguar		+
D	SAM		+
Ŵ	MODIS last day		+
	MODIS last 7 days		+
¢	MODIS last 30 days		+
መ	viirssnpp_last1day		+ ~

Siq shihen dhe nga figurat, secila shtresë e ka nga një shenjë + në anën e djathtë, kur klikohet mbi të hapen informacionet për atë shtresë.

Aetadata 🛛				
0 1	PERGJITHSHEM	HAPËSINORE	≡ SHTRESAT	
Inicimi i Ngjarjes	-Incidentit			
TITULLI	inicimi i Ngjarjes-incidentit			
EMRI	qper inicimi ngjarjes			
BURIMI	postgres			
	Ne kete shtrase menavhohan rastat e reis te i	ngia neve apo incidenteve.		

Informacionet për shtresat janë I përgjithshem dhe Hapesinore. Tek I përgjithshëm janë informacionet gjenerale si: titulli, emri i shtreses, burimi si dhe abstrakti. Pjesa Hapësinore paraqeten informacionet për të dhënat hapësinore, p.sh: Sistemi Koordinativ, gjeometria, shtrirja hapësinore e hartës.

/letadata				×
O I PËRGJITHSHËM		HAPËSINORE	≡ SHTRESAT	^
🕮 Inicimi i Ngjarjes	-Incidentit			-
I PËRGJITHSHËM	ËSINORE			
EPSG	(19512914)			
GJEOMETRIA	Point			
BBOX	minx /431665.5 miny 4088761.5 maxx 7550313 maxy 4766450.5			
🔟 E re (per verifikir	n)			+
🕮 E Verifikuar				+

4.2 Grafiku

Tek menyja e grafikut është paraqitur grafiku me të dhënat për incidente të raportuara në bazë të statusit të rasteve, ku pas klikimit tek menuja hapet dritarja për të dhënat e cekura, në anen e djathtë të sistemit. Në figurën më poshtë është ilustruar grafikoni me incidentet e raportuara, me numër të saktë të rasteve të verifikuar të incidenteve, rasteve që kanë statusin si rast i ri dhe numrin e rasteve të rrejshme.



Përveç kësaj, mund të shihen edhe grafikonë për të dhënat e veçorive specifike; p.sh. tek harta e Analizës së Shpejtë, me identifikimin/selektimin e një poligoni mund të pasqyrohen grafiqe të ndryshme, si ai i Përdorimit të tokës apo Ngastrave pyjore.



Në rastë se nuk selektohet ndonjera prej veçorive, të dhënat në grafikon paraqesin të dhënat e përgjithshme/totale për këtë shtresë.



Butoni i Hartës i filtron të gjithë grafikonët sipas gjeometrive të dukshme në hartë, ku paraqiten të dhëna vetëm për këto gjeometri.





4.3 Printimi

Printimi është procesi i prodhimit të kopjeve fizike të dokumenteve elektronike ose dixhitale, imazheve ose përmbajtjeve të tjera dixhitale në letër.

Sistemi NFFIS ka të integruar shabllonin për printim siq duken dhe në figurën më poshtë: Harta A4. Mund të printohen harta të ndryshme në këtë format.

🖶 Printo
 Shtresat e paraqitura në printim mund të jenë ato të përcaktuara në projekt dhe jo ato të shfaqura në hartë
Shabilon
Harta A4 🗸 🗸 🗸
Shkalla
1:500.000 ~
dpi
150 ~
Rrotullimi
0
Formati
PDF ~
Krijo printim

Përcaktohet shkalla e hartës dhe navigohet tek hapësirë që do të printohet.



Pastaj përcaktohet dpi (rezolucioni i hartës), rrotullimi dhe formati i hartës (pdf apo jpg). Pas përcaktimit të këtyre karakteristikave krijohet Harta dhe shfaqet dritarja për të caktuar vendin e ruajtjes së hartës së krijuar dhe harta është në format pra pdf ose jpg e gatshme për printim (formë fizike).



4.4 Kërkimi

Kërkimi është një mjet kërkimi në një aplikacion, ku në aplikacionin NFFIS mund të kërkoni raportin e demeve, ngjarjen dhe AWS-në. Pas klikimit tek *Kërko Raporton e dëmeve* hapet fusha për shënim të ndonjë karakteri dhe shfaqet në listë ai raport që është gjetur me ato karaktere të shënuara.





Pas klikimit tek search shfaqen rezultatet për raportin e caktuar (figura poshtë, pamja djathtas).

jica 🧐 goer					₹ Ndrysho harlên	🕹 querpr 🗘	CAbout Shqlp • # Home
Kërko	¥ =	Rezultatet Kerko ngjarjen					++ ;; ×
		E Verifikuar (1)					0 -
Kerko ngjarjen			Nr. ngjarjes		Qendra Operative		Ltoff
0002/2020	X T	9 ⊕ ■ ● ∅	0002/2020		OLIPRISHTINE		Ziarre Pyjore
		Informacione mbi ngjarjen	Lokacioni	Pershkrimi	Tjera	B	ashkengjitjet
Kirka		Nr. ngjarjes	0002/2028		Qendra Operative	01 PRISHTIN	•
	- 197	Lloji	Zjanel'sjore		Ngjarja kryesore	NULL	
		Data	2023-08-01	,	Koha/ora	09:45:29	
		Statusi	t, veniñ kuar	,	Kornent per statusin	Eshet venfiku	izdat
		Koment per statusio		=4	chet verifikuaaar		

Tek rezultatet e kërkimit shfaqen informacione të shumta për raportet, ku dhe për një raport të caktuar mund të bëhen dhe editime (ndryshime), plotësime të informacioneve.

4.5 Të dhënat historike

Menuja e të dhënave historike duket kështu:

Layer	
× Ngjarjet-incidente	
Data e fillimit	
2023-05-22 22:00:00	曲
Data e mbarimit	
2023-08-02 22:00:00	#
Hapi [Ditet]	
1	0
Hapat	
0	72
Ditet	

Tek fusha e pare shohim qe eshte shtresa e ngjarjeve-incidenteve, pra ne me kete deshirojme qe ti shohim incidentet ne periudha te ndryshme kohore. Pastaj data e fillimit dhe data e mbarimit, ku në keto data ne e caktojme se prej ciles date deri te cila date tjeter deshirojme te navigojme ne te dhenat historike. Tek hapi (Ditet) mund te caktojme se sa hapa deshirojme te navigojme para ose mbrapa, pastaj tek Ditet mund te nderrrojme ne vite, muaj jave etj.

Ditet	
Shekujt	^
Dekadat	
Vitet	
Muaj	
javet	
Ditet	

144			M	H

Ndërsa butonat më lartë tregojnë si në vijim:

*	Butoni i pare e kthen navigimin ne fillim te hapit
×	Butoni i dyte ben nje hap mbrapa, nese tek ditet eshte caktuar psh. jave atehere me kete buton kthehesh ne navigim nje jave mbrapa.
	Butoni i trete navigon mbrapa ne menyre automatike hapat qe jane caktuar deri në fillim të dates
	Butoni pause, pra ndal navigimin
	Butoni i pestë navigon para në menyre automatike hapat qe jane caktuar deri ne perfundim te dates
M	Butoni i gjashte ben nje hap para
*	Butoni i shtate e dergon navigimin ne fund te hapave

Per te dhenat historike eshte krijuar nje harte e veqante ne sistem, ku ne kete harte kane qasje te gjithe perdoruesit pavaresishte te drejtave. Harta mund te aktovizohet pas klikimit tek baneri larte ndrysho harten, ku pas klikimit hapet dritarja si ne foto dhe klikohet te harta nffis_seriakohore dhe hapet harta.





Navigimi në serine kohore është i njejtë si tek shpjegimi më lartë, vetëm se tek harta e veqantë e serisë kohore janë të integruara shtresat për të cilat mund të bësh navigim në kohë të ndryshme dhe mund të caktosh se për cilat dëshiron të të japin informata në kohë të ndryshme.



E shohim tek figura me lartë tek layer janë më shumë se një shtresë që informatat e tyre mund t'i shohesh në periudha të ndryshme kohore. Nëse dëshiron që për një shtresë të caktuar mos të navigosh në seri kohore, ateherë tek *x* e largon.

Informatë:

Nëse deshiron që ta largosh një shtresë nga navigimi në seri kohore, atëhere të njejtën duhet ta deaktivizosh edhe nga paneli poshtë shtresat (si në foton më poshtë).



4.6 Veglat - Redaktimi

Redaktimi (editimi) është vegël si pjesë e panelit majtas të aplikacionit NFFIS. Redaktimi në një sistem Web GIS zakonisht përfshin bërjen e ndryshimeve ose përditësimeve në të dhënat ekzistuese gjeografike, ose krijimin e të dhënave të tjera të reja, të tilla si shtimi i veçorive të reja, modifikimi i atributeve ose fshirja e të dhënave.



Pas klikimit të *Editing* dhe me pastaj tek *Modifiko shtresat* shfaqen shtresat se në cilën shtresë dëshironi ta bëni redaktimin (editimin).





Veglat për editim për shtresë të tipit pikë:

•••	Shto veçori
	Përditëso të dhënat e veçorisë
	Përditëso të dhënat e veçorisë së zgjedhur
°°	Zhvendos veçorinë
	Ngjit veçorinë nga shtresa tjetër
••	Kopjo veçorinë

Shembulli tjetër është për editimin e shtresës raporti i dëmeve nga zjarri.



Veglat për editim për shtresë të tipit poligon:

and the second s	Shto veçori
	Përditëso të dhënat e veçorisë
N	Përditëso pikën e veçorisë
	Përditëso të dhënat e veçorisë së zgjedhur
	Zhvendos veçorinë
	Ngjit veçorinë nga shtresa tjetër
P	Kopjo veçorinë
	Shto pjesë në shumëpjesë
	Fshij pjesë nga shumëpjesë

	Ndaj veçorinë
(PP)	Bashko veçoritë

4.7 Libërshënuesi hapësinor

Libërshënuesi hapësinor është një veçori që përdoret zakonisht në sistemet GIS, që i lejon përdoruesit të ruajnë dhe të lëvizin lehtësisht në vendndodhje ose zona specifike të interesit brenda një harte ose skene. Ruajtja e faqeve (bookmark) mund të krijohen duke zmadhuar në një zonë specifike, duke vendosur shtrirjen dhe duke i dhënë nje emër ose etiketë.

📕 Libershenuesi hapesinor
×
Leviz ne shtrirje e hartes, vendos emrin dhe shtyp Shto
Name *
Fusha e detyrueshme ose tipi i gabuar i të dhënave (text)
Shto
Libershenuesi i perdoruesit 🕴 🕇
📕 shtime 📕

Ruajtja e faqeve (bookmark) është veqanërisht e dobishme për përdoruesit që punojnë me grupe të dhënash të mëdha dhe kanë nevojë të lëvizin shpesh në vende specifike, pasiqë mund të kursejnë kohë dhe të zvogëlojnë gjasat e gabimeve.

This page is intentionally left blank. Remove this text from the manual template if you want it completely blank.

- M -

Metadata 8